

Universiteti "Kadri Zeka" - GJILAN	Public University
DATE	23.02.2024
NO	057/429



**University of Ruse**



Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan,

shpall këtë:

## **Thirrje për aplikim për shkëmbim të stafit në Universitetin "University of Ruse" Ruse, Bullgari**

Universiteti "Kadri Zeka" është pjesë e projektit KA171 ICM, Erasmus +, në partneritet me Universitetin e Ruses në Bullgari.

Numri i Projektit Erasmus + Project Nr. 2022-1-BG01-KA171-HED-000069917

Programi Erasmus + KA171 ose Shkëmbimi afatshkurtër i stafit (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit "University of Ruse", Bullgari dhe Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e stafit nga Universiteti "Kadri Zeka" - Gjilan për studim dhe trajnim / veprimtari nga të gjitha njësitë akademike dhe administrative të UKZ-së

Të gjitha shpenzimet janë të mbuluar nga projekti:

Shpenzimet e qëndrimit dhe të udhëtimit janë të përcaktuara marrëveshjes për projektin në fjalë sipas Distance Calculator të Erasmus +

([http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)).

Granti i udhëtimit do të paguhet pas lëvizjes në Universitetin përkatës.

### **SHENIME TË RËNDËSISHME:**

- 1) Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen kufizimeve të alokuara buxhetore pasi që nuk ka fonde shtesë.
- 2) Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritësit të udhëtimit dhe edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumën e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtesë për pjesëmarrësit.

## APLIKIMI dhe PËRZGJEDHJA

Kriteret për aplikim për stafin janë:

Të jeni mësimdhënës i rregullt në UKZ apo në rast të stafit administrativ të keni kontratën valide të punës në UKZ.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Kontrata e punës (që dëshmon që jeni staf i rregullt i UKZ-së, apo staf administrativ);

CV në gjuhën angleze (ku janë të përmbledhura edhe punimet shkencore, si dhe te arriturat e tjera dhe përvojat e punës);

Kopje e pasaportës (faqja që përmban emrin tuaj, foton dhe të dhënat personale) ose letërnjoftimit;

Një letër motivimi (në gjuhën angleze);

Kërkohet njohuri e gjuhës angleze e dëshmuar.

Përzgjedhja bëhet:

Në bazë të fushës së përafërt të ligjërimit me fushat e ofruara nga universiteti pritës 50%, dhe fusha juaj e veprimit në UKZ.

Gjuhe e huaj: 50%

## PROCEDURA E APLIKIMIT

1. Aplikimet duhet të dorëzohen në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar (kopje fizike), prej datave 23.02.2024 deri 01.03.2024. Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.

2. Të gjithë aplikantët duhet të jenë në gjendje të sigurojnë dëshminë/ certifikatën e gjuhës angleze, niveli C1 për stafin akademik dhe B1 për stafin administrativ.

3. Aplikantët të cilët ishin pjesë e mobilitetit në të kaluarën nuk kanë përparësi ndaj aplikantëve të cilët aplikojnë për herë të parë në thirrje të llojit të tillë (ata do të kuotohen me pikë negative nga komisioni).

4. Formulari i aplikimit duhet të shtypet, të nënshkruhet dhe t'i dorëzohet me dokumente të tjera të kërkuara: linku për stafin Akademik: [https://erasmus.uni-ruse.bg/en/pimages/54/Annex\\_V\\_-\\_Staff\\_Mobility\\_Agreement\\_teaching\\_2022\\_RU.doc](https://erasmus.uni-ruse.bg/en/pimages/54/Annex_V_-_Staff_Mobility_Agreement_teaching_2022_RU.doc)

linku për stafin Akademik: [https://erasmus.uni-ruse.bg/en/pimages/54/Annex\\_V\\_-\\_Staff\\_Mobility\\_Agreement\\_training\\_2022\\_RU.doc](https://erasmus.uni-ruse.bg/en/pimages/54/Annex_V_-_Staff_Mobility_Agreement_training_2022_RU.doc)

5. Rezultatet e aplikimit do të shpallen në [www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net)

Për cdo informatë shtesë, kontaktoni zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar në UKZ.

Me respekt,

Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka  
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte

